

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË**



**Sistem i qendërzuar për monitorimin e detyrimeve të
prapambetura dhe përmirësimin e kontrollit**

Versioni 3.0

Data 26.10.2017

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
20.03.2017	Grupi i punes	1.0	

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Miratoi: _____ Drejtuesi i Projektit

Miratoi: _____ Përgjegjës për Proceset TIK

Përgatiti: _____ Përgjegjësi TIK

Përgatiti: _____

Person kontakti: _____

Rishikoi: _____ Përgjegjësi i Sigurisë së TIK-ut

Të dhënat e personit të Kontaktit:

<Në tabelën e mëposhtme duhet të paraqitet informacioni në lidhje me zyrtarin që përgatit specifikimet teknike.>

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Adresa e-mail	

PËRMBAJTJA

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK	1
PËRMBAJTJA.....	2
1. HYRJE	5

1.1.	Përfituesi /Autoriteti Kontraktues	5
1.2.	Historiku.....	5
1.3.	Situata Aktuale në Sektor	6
2.	OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	8
2.1.	Objektivi i Përgjithshëm.....	8
2.2.	Qëllimi.....	8
2.3.	Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori	9
3.	SUPOZIMET DHE RISQET	9
3.1.	Supozimet e Projektit	9
3.2.	Risqet.....	10
4.	QËLLIMI I PUNËS	10
4.1.	Të Përgjithshme.....	11
4.1.1.	Përshkrimi i detyrës	11
4.1.2.	Hapësira gjeografike që do të mbulohet	12
4.1.3.	Grupet e synuara	12
4.1.4.	Siguria e sistemit.....	12
4.2.	Detyrat specifike	14
5.	LOGJISTIKA DHE KOHA.....	16
5.1.	Vendndodhja	16
5.2.	Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	16
6.	RAPORTIMI.....	16
6.1.	Kërkesat e Raportimit.....	16
6.2.	Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	17
7.	KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA	17
8.	GARANCIA	18
9.	MIRËMBAJTJA.....	18
10.	PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT.....	18
11.	AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	19
12.	TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	19
13.	KËRKESAT FUNKSIONALE.....	20
	Moduli i të dhënave të subjektit.....	21
	Moduli i detyrimeve të subjektit dhe aprovimit.....	23
	Moduli i monitorimit dhe kontrollit	25
	Moduli i Raportimit	27
	Aplikacioni Mobile	28
	Moduli i Administrimit	29
	Moduli i gjurmëve (logeve)	31

Moduli GIS	31
14. KËRKESAT TEKNIKE	34
14.1 Sistemi software.....	34
14.2 Certifikata SSL.....	36
14.3 Infrastruktura hostuese	36
14.4 Upgrade i sistemit te sigurise	36
14.5 Tokens per autentikim me dy faktore	37
14.6 Tablet PC	37
14.7 Njesi qendrore per ruajtjen dhe ngarkimin e tabletave	38
14.8 Instalimi dhe integrimi i elementeve te infrastruktures	39



1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tiranë.

1.2. Historiku

Taksat vendore janë një detyrim për të gjithë personat juridik dhe fizik në rrethin e Tiranës. Taksat vendore karakterizohen nga lloji i taksës, tipi i taksapaguesit, baza e taksës, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti taimor.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për ndjekjen mbledhjen, dhe realizimin e të ardhurave të planifikuara sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe më konkretisht për :

1. TAKSAT

- 1.1 Taksa mbi ndërtesën (Kategoria II.Ndërtesa te tjera)
- 1.2 Taksa mbi tokën bujqësore
- 1.3 Taksa mbi truallin
- 1.4 Taksa e fjetjes në hotel
- 1.5 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- 1.6 Taksa e tabelës
- 1.7 Taksa e perkohshme për infrastrukturën arsimore (Kategoria II.Biznesi)

2. TARIFAT

- 2.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave (Kategoria II.Biznesi)
- 2.2 Tarifa për zënien e hapësirave publike
- 2.3 Tarifa për dhënie liçence për tregtim karburanti e lënde djegëse
- 2.4 Tarifa e shërbimit veterinar
- 2.5 Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Tiranë

Në zbatim të ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore.”Ne zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak, Nr. 59, dt. 30/12/2015 “ Per Sistemimin e Taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Tiranës “ DPTTV ndjek marrëdhëniet me agjentët tatimore për taksat vendore si mëposhte:

- Takse e regjistrimit të mjeteve të transportit - Drejtoria e Transportit Rrugor
- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin - Drejtoria Rajonale Tatimore
- Taksa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave (kategoria –Familjare) – Ujesjelles-Kanalizime
- Taksa e perkohshme e infrastructures arsimore per kategorine- Familjare – Ujesjelles-Kanalizime
- Taksa e kalimit të pronësive - ZRPP
- Taksa e ndërtesës , (kategoria- ndërtesa banimi) – Ujesjelles-Kanalizime

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Financës, Njësitë Administrative, Institucionet dhe Ndërmarrjet e varësisë së Bashkisë së Tiranës.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Bashkia e Tiranës, në saj të politikave të aplikuara, kuadrit rregullator dhe informatizimit synon forcimin e disiplinës fiskale në zbatimin e drejtë, të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e evazionit fiskal dhe krijimin e një sistemi të drejtë tatimor.

Aktualisht DPTTV ka e vetme rolin bazë për informimin për taksat e tarifat, regjistrimin e bizneseve dhe qytetarëve, llogaritjen e detyrimeve, rillogaritjen, kontrollin e territorit dhe bizneseve, mbledhjen e taksave dhe tarifave si dhe mbledhjen me forcë të detyrimeve. Verifikimi i subjekteve taksapaguese debitore realizohet nga kontrolli në terren i agentëve (operatorëve), aprovohen rastet e detyrimeve të rregullta dhe evidentohen rastet e shkeljeve apo parregullsive të caktuara. Kontrolli në terren kryhet në disa mënyra: kontroll i agentëve në zonën e tyre për të plotësuar regjistrin e bizneseve, të peregjistruarit, të regjistruarit e rinj etj; urdhërin për kontroll të taksës së pasurisë, verifikim, plotësim, saktësim etj të bëra me urdhër të DP pas realizimit të një analize risku; verifikime për problematika të hasura si mungesa dokumentacioni dhe informacioni etj.

Qëllimi i sistemit të ri del jashtë mundësive funksionale dhe teknike të sistemit aktual të taksave, për shkak të teknologjisë së vjetëruar të ndërtimit dhe pamundësisë teknologjike të shtimit ,zhvillimit të moduleve të reja në sistemin ekzistues, (zhvilluar në vitin 2009). Aktualisht sistemi i taksave gjeneron listën debitoreve dhe ndjekja e mëtejshme e procesit bëhet në forme shkresore. Pikërisht për këtë arsye lind domosdoshmëri ndërtimi i një sistemi të ri për monitorimin e detyrimeve të subjekteve nëpërmjet mundësive të vetdeklarimit dhe ndjekjes së mëtejshme të procesit.


Gjate vizites se agjenteve ne terren, (kontroll i agjenteve ne zonen e tyre per te plotesuar regjistrin e bizneseve, te peregjistruarit, te regjistruarit e rinj) mbahen procesverbale mbi gjendjen aktuale te subjekteve nder te tjera edhe per rastet kur ka mosperputhje me gjendjen e deklaruar si: mosregjistrim i biznesit (mosregjistrim i NIPT-eve sekondare, mos regjistrim ne kategorine e caktuar per disa lloj taksash e tarifash); mosregjistrim i prones; mosregjistrim i siperfaqeve te reklames dhe hapsirave publike; funksionim edhe pas mbylljes, pezullimit ne QKB; regjistrim i siperfaqeve me te vogla te ndertesave etj. Informacioni i mbajtur ne procesverbale hidhet nga operatoret ne sistemin aktual te taksave duke bere update te informacionit ekzistues.

Vetë operatorët(agjentët në terren) janë subjekt i kontrollit nga njësitë e kontrollit të Bashkisë së Tiranës. Kontrolli ndaj agentëve në terren bëhet përmes kontrollit të dokumentacionit që ata dorëzojnë për punën e kryer si dhe duke qenë ata vetë objekt kontrolli në terren, në rastet

kur ka indicie për parregullsi. Njesite e kontrollit do jene perdorues te sistemit dhe mund te kontrollojne aktivitetin e agjenteve ne cdo kohe

Me përfshirjen e shumë aktorëve, monitorimi i taksapaguesve, detyrimet e tyre ndaj institucionit, rastet debitore dhe kontrolli i saktë dhe transparent nga ana e operatorëve e njësive të kontrollit ka lindur nevojën e një sistemi të informatizuar, i cili do të përmirësojë monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e gjithë ciklit të punës. Nga sistemi i taksave ekzistues del lista e debitoreve dhe ndjekja e procesit behet ne forme shkresore. (detajuar edhe me tej ne kete paragraf) Aktualisht njoftimi i subjekteve per detyrimet per taksat dhe tarifat ndiqet ne forme shkresore, njoftohen subjektet nepermjet shkresave zyrtare derguar nga DPTTV. (Detyrimet e subjekteve printohen nga sistemi dhe ruhen ne dosje).Pas perfundimit te afatit ligjor per pagesat respektive, procesi ndiqet në formë shkresore për masa administrative sipas ligjeve në fuqi (psh kundrejt bankave per bllokimin e llogarive bankare te subjekteve me gjendje borxhi).

Në bashki gjendet një dhomë serverash e dedikuar për sisteme informatike, ku planifikohet të instalohet sistemi dhe të aksesohet nëpërmjet aksesit në rrjetin e brendshëm dhe përmes aksesit në internet per agjentet/operatoret që janë në terren. Godina qendrore e bashkisë së bashku me 12 godina të tjera të saj, lidhen në intranet nëpërmjet fibrës optike. Toplogjia e rrjetit paraqitet në diagramën e mëposhtme:



2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Në mënyrë të vazhdueshme, Bashkia haset me raste të mos pagimit të taksave dhe detyrimeve që subjekte të ndryshme kanë kundrejt saj. Kjo gjë sjell një efekt negativ në të ardhurat e bashkisë. Në mënyrë që situata të tilla të shmangen ose problematikat e krijuara të mbahen nën kontroll është e nevojshme ndjekja rigoroze e tyre.

Zgjidhja që kerkohet është një sistem i cili me nderhyrje minimale nga ana e punonjesve të bashkisë të mund të ndjeke efektivisht të gjithë rastet e detyrimeve të prapambetura me qëllim arketimin e tyre në kohën me të shkurter të mundshme. Identifikimi i këtyre rasteve duhet të vijë si rrjedhojë e të dhënave të marra përmes integritit me sistemet ekzistuese të taksave dhe financiare të bashkisë, të dhënave të marra përmes kontrollit të agjentëve në terren dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përmes një ndërfaqeje online që do u ofrohet. Gjithashtu duke lejuar mundësi bashkëngjitjeje të dokumentacionit apo të dhënave mbi pagesat e kryera, komente mbi situatën në terren sic mund të jenë çështjet e hasura apo problematika që kanë ndikuar në procesin e pagesave. Kjo do të ndikonte në lehtësimin e procedurës së verifikimit të deklarimeve të subjekteve dhe verifikimin në vend të detyrimeve të tyre. Implementimi i këtij sistemi do të permiresojë dhe lehtësojë identifikimin e subjekteve debitoare.

Gjithashtu sistemi synon të ndikojë pozitivisht në rritjen e taksave të mbledhura duke patur një komunikim korrekt dhe informim në kohë reale për çdo veprim të marre nga ana e bashkisë kundrejt debitorëve të saj me qëllim zgjidhjen e problematikave në interes të të dy paleve.

Sistemi pritet të sjellë në një platformë të vetme të qendëruar të gjithë informacionin e marrë nga subjektet me nivelet e ndryshme të detyrimeve të mbetura dhe mundësisë së pagesave, duke minimizuar daljen e inspektorëve në terren dhe identifikimin e mundësive të ndryshme të pagesave dhe negocimit, gjë që nuk e ofrojnë sistemet ekzistuese.

Në këtë mënyrë raportimi dhe kontrolli do të jete në kohë reale dhe i drejtperdrejte. Duhet theksuar fakti se agjentët e drejtorisë DPTTV do të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre nëpërmjet daljes në terren por ky proces do të lehtësohet nëpërmjet implementimit të këtij projekti.

2.2. Qëllimi

Ky projekt ka për qëllim:

- Sigurimin e një sistemi, ku i gjithë procesi i deklarimit, aprovimit të deklarimit dhe kontrollit do të menaxhohet brenda tij, duke mundësuar menaxhim të plotë dhe të besueshëm.
- Implementimin e një sistemi, i cili do të permiresojë identifikimin në pagesat e taksave dhe detyrimeve dhe do të mundësojë riskedulimin dhe krijimin e planeve individuale për takspagues të ndryshëm.

- Sigurimin e nje komunikim te mire dhe informim në kohë reale duke ndjekur ne menyre te automatizuar te gjithë procesin
- Sigurimin e te gjithë informacionit të kerkuar duke mundësuar që procesi i ndjekjes se rasteve te detyrimeve ne vonese behet me i lehte dhe efikas per operatorët, duke ju kursyer kohe dhe duke maksimizuar rezultatin.
- Reduktimin e daljes në terren të agjentëve përmes vetëdeklarimeve të subjekteve, duke sjellë përmirësimin dhe lehtësimin e procesit të punës, për të verifikuar çdo subjekt, por duke u përqendruar vetëm tek subjektet që do jenë objekt kontrolli me statusin e debitorit.
- Krijimin e mundësisë së komunikimit online me debitorët, duke iu ofruar disa alternativa apo lehtësime në mënyrën e kryerjes së pagesave.
- Integrimin e sistemit ne infrastrukturen e bashkise.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga Kontraktori në kuadër të këtij projekti do të jenë:

- Njohje me procedurat e punes se institucionit lidhur me administrimin dhe mbledhjen e taksave vendore duke u bazuar ne legjislacionin perkates
- Njohja me procedurat e punes se institucionit lidhur me kontrollin dhe monitorimin e subjekteve taksapaguese nga ana e operatoreve dhe njesive te kontrollit
- Implementimi i një sistemi informativ i cili do të administrojë këtë proces duke krijuar edhe një bazë të dhënash të subjekteve në fjalë, si dhe aplikacionin mobile që do të mund të përdoret
- Furnizimi dhe Instalimi i elementeve infrastrukture te nevojshem për hostimin dhe operimin e sistemit, dhe integrimin me sistemet e tjera, pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë.
- Zhvillimi, testimi dhe Instalimi i sistemit software, dorëzimi i tij ne baze te procedurave te miratuara
- Trajnimi i perdoruesve
- Hartimi i procedurave teknike te perdorimit dhe mirembajtjes se sistemit
- Sherbimet e suportit dhe mirembajtjes per nje periudhe kater vjecare

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Bashkia Tiranë presupozon që sistemi elektronik i cili do të mundësojë forcimin e kapaciteteve menaxhuese të Bashkisë bashkë me të gjitha të dhënat që nevojiten për funksionimin e tij do të instalohen pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë.

- Do të ngrihet një grup pune i posacëm me të cilët do të jenë përgjegjes për të gjitha fazat e zhvillimit të projektit.
- Supozohet pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti
- Caktimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti nga të gjitha palët e interesit
- Sigurimi i komunikimit të nevojshëm midis departamenteve përgjegjës në Bashkinë e Tiranës

Gjithashtu duhet mbajtur parasysh fakti që realizimi i të ardhurave ka një përqindje pasaktësie për shkak të mungesës së një procesi transparent dhe regjistrimit në mënyrë elektronike të të dhënave të nevojshme për kontrollin në terren të subjekteve dhe përditësimin real të informacionit. Deri më tani këto identifikime kryhen përmes agjentëve të cilë operojnë sipas zonave që iu janë caktuar duke bërë verifikime në terren dhe vlerësim detyrimesh mbi bazën e këtyre verifikimeve manuale, duke rritur mundësinë e gabimit në hedhjen manuale të të dhënave pa pasur një mundësi të dytë kontrolli.

3.2. Risqet

Duke u bazuar në nevojën për një sistem të verifikimit të taksave dhe mbledhjes së detyrimeve në vonesë, Bashkia Tiranë e konsideron një prej projekteve të rëndësishme të saj.

Si çdo projekt, ekzistojnë një sërë risqesh për implementimin dhe përfundimin me sukses të këtij projekti. Disa prej tyre renditen si më poshtë:

- Detaje ende të papërcaktuara të funksionimit të verifikimit të detyrimeve të taksapaguesve, kontrollit të operatorëve dhe monitorimit të njësive të kontrollit.
- Koha relativisht sfiduese për implementimin e projektit dhe niveli fillestar i përdorueshmërisë së tij nga përdoruesit fundorë. -
- Paqartësia e kërkesave apo kuptimi jo i saktë dhe rrjedhimisht implementimi jo i saktë nga operatori ekonomik.
- Experienca e stafëve që do të përfshihen në realizimin e projektit.
- Mungesa e përshtatshmërisë të aplikacionit me kërkesat dhe pritshmëritë e përdoruesve –

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore mbi të cilën do ndërtohet sistemi:

- Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore.
- Ligjin nr.9920 date 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.3, datë 05.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.3, datë 28.02.2008 “ Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.3, datë 05.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.
- Vendimin nr. 18, dt.26.04.2004 të Këshilli Bashkiak “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore“
- Të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi sikundër dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për këtë qëllim.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Detyrat që lindin nga ndërmarrja e këtij projekti mund të listohen si më poshtë:

- Analiza e situatës aktuale, bazës ligjore, procedurave në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të subjekteve taksapagues dhe procesin e kontrollit dhe monitorimit nga ana e operatorëve e njësive të kontrollit
- Përcaktimi i nevojave dhe menyres se integritetit në infrastrukturë si dhe burimeve njerëzore për zbatimin e projektit.
- Dizajnimi i proceseve aktualë të punës si edhe identifikimi i nevojave për ndryshim të tyre.
- Dizajnimi i një sistemi informatik i cili përmbush funksionalitetet e kërkuara dhe ndërtimi i tij
- Instalimi i sistemit dhe integrimi me sistemet e menaxhimit të taksave vendore, sistemet e menaxhimit financiar (ERP), sisteme të brendshme të rrjetit, dhe Geoportalin shtetëror ASIG nëse do jete e nevojshme.
- Upgrade i sistemit ekzistues të sigurisë, upgrade të pajisjeve ekzistuese Fortinet FG-100C
- Testimi i sistemit (teknik dhe funksional) bazuar në një plan të miratuar më parë
- Trajnimi i përdoruesve të sistemit (drejtoritë e Bashkisë e Tiranës) si edhe përgatitja e manualeve të përdorimit.
- Marrja në dorëzim e sistemit software dhe pajisjeve të nevojshme përfaqëse në projektin
- Popullimi i sistemit me të dhënat fillestare të nevojshme
- Suporti dhe mirëmbajtja

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Bashkia Tiranë

4.1.3. Grupet e synuara

- Bashkia e Tiranës
- Stafi i Bashkisë
- Taksapaguesit

4.1.4. Siguria e sistemit

Sistemi do të ketë nivele të ndryshme aksesit sipas rolit (RBAC) duke mbajtur parasysh konfidencialitetin për të dhënat që klasifikohen si të tilla. Veçoritë dhe karakteristikat për çdo përdorues do të specifikohen gjatë fazës së analizës dhe dizenjimit.

Siguria duhet të ofrohet në disa forma dhe nivele për të mbrojtur informacionin dhe për të lejuar akses përdoruesve sipas parimit “jo më shumë se cfarë nevojitet”. Duhet të aplikohet parimi i katër syve (four eye principle). Ky akses duhet të jetë i konfigurueshëm sipas nevojave që ndryshojnë në kohë, pa patur nevojë për ndërhyrje në kod, apo ndërhyrje të tjera direkt në databazë apo në skedarë konfigurimi.

Rolet dhe të drejtat e aksesit për secilin rol duhet të jenë të menaxhueshme nga administratori i sistemit nëpërmjet ndërfaqes së përdoruesit.

Kjo logjikë do jetë pjesë e modulit të administrimit, në të cilin do kenë të drejtë përdorues specifikë, e shoqëruar me ndërfaqet respektive për të kryer konfigurimet në mënyrë të thjeshtë, vetëshpjeguese dhe pa dykuptimësi.

Akseset duhet të organizohen në formën e roleve, përdoruesve, të drejtave dhe relacioneve mes tyre. Të drejtat janë objekt i pandryshueshëm në një moment të caktuar, duke paraqitur funksionalitetet që ofrohen nga sistemi. Ndërkohë, rolet dhe përdoruesit, relacionet mes tyre dhe konfigurimi i të drejtave për role të ndryshme, janë dinamike dhe si rrjedhim objekte ndryshimi. Për sa më sipër, kërkohet të realizohet një skemë autorizimi e konfigurueshme e njohur si RBAC (Role-Based Access Control).

Është e rëndësishme që cdo ndryshim lidhur me të drejtat duhet të pasqyrojë efekte të menjëhershme në sistem.

Çdo e dhënë e nevojshme duhet të ruhet në databazë, e organizuar sipas një skeme të përshtatshme që mbështet funksionalitetet e kërkuara. Të dhënat sensitive, si psh fjalëkalimet, duhet të jenë të enkriptuara. Për arsye sigurie, entitetet ku mbështetet moduli i menaxhimit të përdoruesve, roleve dhe të drejtave, duhet të jenë minimalisht në një skemë të ndarë nga skema e entiteteve ku do mbështetet logjika e sistemit; preferohet që këto entitete të mbahen në një databazë të ndarë dhe të dedikuar.

Vizualisht, konfigurimi i modelit të aksesit duhet të shfaqet në formë matricore ku kryqëzohen të drejtat (të pa ndryshueshme) me rolet (të ndryshueshme).

Përdoruesit mund të jenë të dy tipeve:

- Mund të autentikohen me përdorues+fjalëkalim të dedikuar për këtë sistem (akses i jashtëm)
- Mund të autentikohen duke përdorur përdoruesin përkatës në Active Directory (akses i brendshëm)

Akseset duhet të jenë transparente nga tipi i përdoruesit dhe sistemi duhet të suportojë të dy tipet e përdoruesve.

Sistemi duhet të ofrojë mundësi përzgjedhjeje të objekteve mbi të cilat një përdorues mund të aplikojë të drejtat që trashëgon nga roli/rolet ku ai bën pjesë, për shembull, një përdorues që ka të drejta operatori për aprovimin e detyrimeve të subjekteve, nuk duhet të ketë të drejta mbi çdo subjekt, por vetëm mbi një ose disa objekte që janë nën përgjegjësinë e tij.

Modifikimi i akseseve për një rol të caktuar, në vecanti heqja e një të drejte, nuk duhet të shoqërohet vetëm me mungesën grafike të linkut/butonit/menusë, por edhe me kufizimin e përdoruesit për të thërritur në ndonjë formë tjetër funksionalitetin në fjalë. Duke patur parasysh që aplikacioni do jetë i aksesueshëm në Web, në këtë mënyrë mund të sigurohemi se në asnjë lloj forme nuk mund të përfitohet e drejta mbi veprime apo të dhëna që përdoruesit nuk i lejohet t'i ketë.

Sistemi duhet të aksesohet nëpërmjet single sign-on dhe integritit me direktorinë aktive (AD) të institucionit aty ku do të jetë e mundur dhe e përshtatshme (për përdoruesit e stafit të Bashkisë).

Për përdorimin e modulit të menaxhimit nga subjektet që do ta zgjedhin këtë shërbim apo nga përdoruesit privatë të cilët janë subjektet debitore, do të ketë lidhje të sigurt nëpërmjet SSL VPN (HTTPS, FTPS apo protokolle të tjera që do të suportohen mbi SSL) si edhe një llogari të mbrojtur me fjalëkalim për secilin përdorues. Integritet të cilat do të jenë të nevojshme, si psh integriti me sisteme të treta të vetë Bashkisë, do të kryhen nëpërmjet autentikimit server-server për shërbimet web (web services)

Çdo veprim në sistem do të regjistrohet (përmes logeve) duke përcaktuar qartë përdoruesin, kohën e veprimit (timestamp), llojin e veprimit (lexim, ndryshim, përditësim), të dhënat e ndryshuara, IP e përdoruesit etj.

Duhet të mbahen loge të detajuara mbi çdo aktivitet që kryen çdo përdorues apo edhe i aktiviteteve anonime. Kjo logjikë duhet të jetë e pavarur, transparente dhe të mos ndikojë në proceset që realizojnë logjikën e sistemit.

Sistemi duhet të ofrojë ndërfaqjen respektive për paraqitjen e logeve si dhe mundësi për filtrimin e tyre, për gjetjen e shpejtë të gjurmëve që kërkohen dhe pamundësi të modifikimit të tyre. Kjo ndërfaqje do jetë pjesë e modulit të administrimit.

Sipas nevojës, duhet që sistemi të ofrojë mundësi gjurmimi për arsye auditi edhe të objekteve të databazës për veprime që manipulojnë informacionin: krijim, modifikim dhe fshirje. Duhet të mbahen loge mbi llojin e veprimit, objekti i cili i nënshtrohet këtij veprimi, vlerat e fushave të tij (si ishin, si u bënë), atje ku kjo logjikë aplikohet.

Me qenë se cdo veprim do kryhet nëpërmjet ndërfaqjeve specifike, loget për gjurmimin në nivel objekti duhet të lidhen me loget që lë cdo ndërveprim i përdoruesit me sistemin, në një organizim hierarkik të tipit shkallë-pasoje.

Sistemi mobile duhet të përmbajë keto elemente sigurie:

- Thin client, që do të sigurojë operimin si një sistem operativ online. Të gjitha të dhënat dhe proceset e aplikacionit duhet të jenë në një server qendror, duke mos mbajtur asgjë në mobile.
- Autentikimi dhe autorizimi duhet të kryen me Token në cdo thirrje
- Token based authentication, duhet të dërgohet në cdo kërkesë, duhet të mbrohet me protokollin e komunikimit HTTPS ssl
- Funksionimi duhet të jeten mbi bazën e Web API që fsheh detajet e tjera në Business Logic dhe ekspozon vetëm metodat e nevojshme si dhe të dhënat në një format të mirëpërcaktuar, për të cilat duhet të bëhet validim.

4.2. Detyrat specifike

Detyrat specifike që lindin nga implementimi i këtij projekti mund të listohen si më poshtë:

- **Analiza dhe përgatitja e fillimit të projektit**
 - Ngritja dhe konfirmimi i grupeve të punës që do të marrin pjesë në projekt
 - Përcaktimi i procedurave standarte të proceseve të punës si dhe informacionit të detajuar të nevojshëm për kryerjen e këtyre procedurave
 - Planifikimi i burimeve njerëzore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit nga secila palë
 - Identifikimi i ndryshimeve të mundshme në proceset e punës dhe përgatitja e opinioneve ligjore mbi këto ndryshime
 - Përgatitja e formularëve standardë
 - Paraqitja në mënyrë skematike e proceseve të punës (workflow diagram)
- **Dizenjimi i sistemit**
 - Njohje me infrastrukturen dhe sistemet ekzistues, nevojat për hardware, software dhe infrastrukturë mbështetëse për ambientet test dhe live si dhe për funksionin backup. Përcaktimi i kërkesave minimale për përdorimin e sistemit. Për të realizuar një design të ri të sistemit, ku duhet të përcaktohen të gjitha elementet që do preken nga sistemi i ri dhe si do ndikojnë keto ndryshime në

elementet ekzistues te infrastruktures. Ne design duhet te sigurohet impakt minimal ne funksionalite gjate implementimit te sistemit te ri.

- Përgatiten specifikimet teknike për ndërfaqësim me sisteme të treta te vete bashkise te percaktuar edhe ne piken 7.
- Dizenjimi i arkitekturës teknike dhe logjike të sistemit.
- Dizenjimi i bazës së të dhënave, përcaktimi i entiteteve kryesore dhe attributeve të tyre.
- Përcaktimi i nevojave dhe specifikimeve për konektivitet mes sistemit dhepërdoruesve të tij fundorë.
- Përgatitja e ambienteve teknikë për zhvillim, testim dhe live të sistemit për kontrollin dhe aprovimin e detyrimit të subjekteve dhe monitorimin nga njësitëe kontrollit në Bashkinë Tiranë.

- **Zhvillimi i sistemit**

- Programimi i sistemit informatik të menaxhimit të detyrimeve të taksapaguesve, aprovimit dhe monitorimit në përputhje me proceset e punës dhe formularëve të standardizuar të përcaktuara më parë, duke respektuar standardet dhe praktikat më të mira për ndërtimin e sistemeve informatike dhe gjithë komponentëve të tij si psh: bazën e të dhënave, modulet informatike, ndërfaqen e sistemit, shkrimin e testeve per cdo element te programit softuerik etj.

- **Planifikimi i testimit të sistemit (teknik dhe funksional)**

- Plani i testimit duhet të përmbajë skenarë të detajuar testimi, si edhe përcakton testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimit dhe marrjes në dorëzim
- Plani i testimit nis dhe zhvillohet paralelisht me programimin e sistemit informatik , duhet të ketë përfunduar dhe të marrë aprovimin e Kontraktuesit para testimit te sistemit informatik.
- Ndërkohë, në përfundim të fazës së ndërtimit të sistemit informatik, operatori implementues duhet të zhvillojë testimin teknik të sistemit, si një aktivitet të veçantë nga ndërtimi i sistemit.
- Testimi teknik i programit duhet te kryhet permes njesive software te testit te pergatitura nga Operatori.

- **Trajnimi i përdoruesve të sistemit, përgatitja e manualeve të përdorimit**

- Identifikim i nevojave për trajnim dhe materialeve të nevojshme për trajnim
- Organizim i trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe administratorët teknikë të sistemit
- Dorëzimi i manualeve të përdorimit

Furnizimi, instalimi dhe marrja në dorëzim

- *Për infrastrukturën hardware*

- Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve
- Vendorsja e konektivitetit mes sistemit dhe përdoruesve përmes integritetit të pajisjeve dhe sistemeve
- Testimi i pajisjeve dhe lidhjeve online
- Përgatitja e ambientit për implementim të sistemit informatik
- *Për sistemin informatik (software)*
 - Instalimi dhe konfigurimi në infrastrukturën hostuese IT të Bashkisë.
 - Zbatimi i skenarëve të testimit të UAT sipas planit dhe dokumentimi i rezultateve
 - Korrigjimi i gabimeve të raportuara gjatë fazës së testimit deri në marrjen e versionit final të sistemit që kalon suksesshem çdo test të përcaktuar në planin e testeve.
 - Hapja e profileve të përdoruesve dhe popullimi me të dhënat fillestare
 - Go-Live (Vendosja në punë)
- **Mirëmbajtja e sistemit pas vendosjes në punë**
 - Mirëmbajtje preventive nëpërmjet kontrolleve dhe auditimit të log-s
 - Ndërhyrje për zgjidhje problematikash

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Bashkia Tiranë,

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 56 muaj nisur nga kjo datë.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal dhe 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet katër javë nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura, si dhe rezultatet e

analizes kryesore mbi proceset e punes qe pritet te mbeshteten nga sistemi. Kontraktori duhet te vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar

- **Raport mujor i progresit** i faqeve maksimale 5 (teksti kryesor), duhet dorëzuar cdo fund-muaji gjatë projektit dhe mirëmbajtjes. Ky raport duhet të paraqesë gjetjet më kryesore të punës së muajit në fjalë dhe planin për muajt pasardhës. Autoriteti Kontraktues mund të japë feedback për këtë 10 ditë nga dorëzimi i raportit.
- **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranura nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 7 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Për të mundësuar komunikimin e sistemit me sisteme dhe databaza të tjera të vetë Entit apo qendrore, duhet që sistemi që do ndërtohet të suportojë mundësi komunikimi nëpërmjet WEB API apo rruge të tjera.

Kërkohet që sistemi informatik për menaxhimin e taksapaguesve dhe situatave debitore, të ndërveprojë me të paktën këto sisteme të Bashkisë së Tiranës:

- Sistemi i taksave vendore, ndertuar ne 2009, gjuha e programimit SAL, ambjenti i punes unify 5.1, database oracle 11g
- Sistemet e menaxhimit financiar (ERP) ndertuar ne 2017, gjuha e programimit Python, baza e te dhenave PostgreSQL,
- Shërbimet e brendshme të rrjetit

Dhe nese do jete e nevojshme edhe me:

- Geoportali shtetëror ASIG

8. GARANCIA

Garancia e sistemit do te jete te pakten 1 vit, ndersa per pajisjet fizike do te jete sipas kerkesave ne piken 14 per secilen prej tyre.

9. MIRËMBAJTJA

Bazuar në VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, periudha e mirëmbajtjes do të jetë 4 vjet.

10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Njesia	Çmimi/njësi	Vlera
1	Sistemi i qendërzuar për kontrollin dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Tiranë (zhvillim sistemi, instalim)	1	cope		
2	Infrastruktura hardware hostuese (furnizim, instalim)	1	cope		
3	Licence Vmware	1	copë		
4	Upgrade i sistemit te sigurise				
4.1	Firewall dhe BDL	3	cope		
5	Tokens 2FA	70	cope		
6	PC Tablet	25	cope		
7	Njesi qendrore per ngarkimin dhe ruajtjen e tabletave	1	cope		
8	Certifikate SSL per multidomain names	4	vite		
9	Integrimi i elementeve 2-8 (të kësaj tablele) ne rrjetin e bashkise	1	cope		
10	Trajnim	4	jave		
11	Mirëmbajtje për te gjithë elementet e projektit	4	vite		
	Totali pa TVSH				
	TVSH (20%)				
TOTALI ME TVSH (LEKË)					

11.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9-M56
1	Faza Përgatitore për sistemin software									
2	Lëvrimi i pajisjeve hardware, instalimi dhe konfigurimet perkatese									
3	Faza e zhvillimit të sistemit software									
4	Faza e testimit të sistemit software dhe instalimit e konfigurimit									
5	Trajnimi i përdoruesve									
6	Marrja në dorëzim									
7	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes									

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Çdo e drejte mbi kodin burim, informacionin apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin e ndërtuar, instalimet e produkteve software apo hardware, skema të konfigurimeve dhe lidhjeve të tyre, duhet t'i kalojë Autoritetit Kontraktor në format elektronik dhe në letër.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE


Sistemi i qendërzuar për menaxhimin e detyrimit të subjekteve taksapaguese në Bashkinë e Tiranës, do të aksesohet nëpërmjet web-it si dhe aplikacionit mobile, dhe do të ofrojë, duke përfshirë (por jo i kufizuar) funksionalitetet si më poshtë:

- Krahësim i vlerave të hedhura në sistemin e menaxhimit të taksave me ato të vetedeklaruara nga subjekti dhe ato të konstatuara nga agjenti në terren. Verifikimi i vlerës dhe statusit të detyrimit të subjekteve debitore në kohë reale, për të verifikuar totalin e detyrimit apo për statusin aktual të vlerës së mbetur të detyrimit pas pagesave të kryera nga subjekti, aprovimi dhe kontroll nga operatori dhe njesitë e kontrollit
- Ruajtja e historikut për çdo veprim dhe në çdo rast kontrolli, aprovimi dhe mbledhje detyrimi.
- Përmirësim i ndjeshëm edhe vendosja e saktë e detyrimeve për bizneset dhe operatorët e ndryshëm si dhe përmirësimi i kontrollit të tyre
- Të dhëna të organizuara sipas subjekteve, statusit debitore ose jo, gjendjes aktuale të detyrimit pas pagesës/pagesave të kryera në bazë të planit të negociuar dhe aprovimit të vlefshmerisë së vetedeklarimeve
- Mundësi kerkimi të shpejtë dhe të lehtë e të dhënave të të debitorëve dhe gjenerimi të raporteve për detyrimet e tyre
- Mundësi aksesimi nga agjentët në terren të sistemit përmes aplikacionit mobile, në mënyrë që të kenë mundësi validimi, hedhje të dhenash dhe regjistrimi veprimesh në sistem në kohë reale nga pika e monitorimit të tyre në terren.
- Lehtësimi i procedurës së verifikimit të deklarimeve të subjekteve dhe verifikimi në vend i detyrimeve të tyre.
- Sigurimi i një komunikimi të mirë, korrekt dhe efikas për çdo veprim të marrë nga ana e bashkësive kundrejt debitorëve të saj me qëllim zgjidhjen e problematikave në interes të të dy palëve.
- Ndërfaqe integrimi me sisteme të treta për sinkronizim të dhenash lidhur me të dhënat e subjekteve, detyrimet e tyre dhe shlyerjet e detyrimeve.
- Ndjekja në mënyrë të automatizuar i të gjithë procesit, efekti pozitiv i dyanshëm si për Bashkinë e Tiranës, ashtu edhe për taksapaguesin
- Standarde në masat e sigurisë për të shmangur hyrje të paautorizuara në të dhënat e sistemit
- Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të jenë të mundura të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë.
- Sistemi (ndërfaqet, menu-të, butonat dhe mesazhet që marrin përdoruesit e sistemit) duhet të jetë në gjuhën shqipe. Duhet të ekzistojë në çdo rast mundësia e shtimit të një gjuhe tjetër.
- Sistemi do të aksesohet nga jashtë rrjetit, nga përdoruesit e Bashkisë përmes një lidhjeje të sigurtë SSL VPN, të siguruar me autentikim me dy faktore (tokens), ndërsa për përdoruesit e jashtëm (subjektet e biznesit) sistemi do të publikohet duke u aksesuar përmes një lidhjeje të sigurtë HTTPS. Po ashtu HTTPS do të jetë edhe lidhja nga brenda

rrjetit. Keto vlejne si per aksesin web, ashtu dhe per ate Mobile. Sigurimi i sherbimit te internetit si per sistemin qendror ashtu dhe per pajisjet fundore nuk eshte pjese e ketij projekti. Kjo do te realizohet nga vete bashkia.

Gjithsesi pajisjet e kerkuara duhet te ofrojne mundesi lidhjeje me wi-fi dhe gsm/3g sic eshte kerkuar edhe ne specifikimet e tyre teknike.

Më poshtë paraqitet bllokskema ilustruese mbi funksionalitetet e sistemit dhe komunikimin.



Moduli i vetdeklarimit te te dhenave të subjektit

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Cdo subjekt vetdeklarues duhet të regjistrojë të dhëna të përgjithshme dhe financiare në sistem.	
002	Të dhënat duhet të ruhen në sistem sipas formatit të përcaktuar në Drejtorinë e Taksave.	
003	Të dhënat e subjekteve ekzistuese do të ngarkohen nga sisteme bashkëvepruese të Bashkisë së Tiranës dhe Drejtorisë së taksave përmes integritit me të sistemit të ri	
004	Të dhëna të tjera mund të shtohen manualisht sipas nevojës.	
005	Te dhenat e marra përmes integritit me sisteme të brendshme të bashkise do jone të pamodifikueshme.	
006	Te dhenat në lidhje me informacione që nuk mund të merren përmes integritit, do të vendosen manualisht në sistem nga subjektet vetedeklaruese me mundësi modifikimi të mevonshëm	
007	Per cdo ndryshim në të dhenat e subjektit, të ruhen loge mbi përdoruesin që ka kryer ndryshimin, vlerën e vjetër dhe vlerën e re të marrë pas ndryshimit.	
008	Të dhënat e përgjithshme do të ruajnë informacion lidhur me të dhëna juridike dhe deklaruese në QKB	
009	Të dhënat e kontaktit do të jenë të detyrueshme pasi do të kushtëzojnë edhe njoftimin automatik me email apo sms nga sistemi, për vonesat në shlyerjen e detyrimeve	
010	Të dhënat financiare do të ruajnë informacion mbi detyrimet e subjekteve, specifikisht për çdo detyrim takes dhe në total: • Nr sekuencial i transaksionit • Përshkrimi i llojit të detyrimit që ka subjekti • Gjendja në para e llogarise • Gjendja në arke • Gjendja në banke • Likuidimi total • Gjendja pas likuidimit	
011	Te dhena në lidhje me kushtet e pagesës për të cilën është negociuar dhe rënë dakord me agjentet	

012	Të dy llojet e të dhënave do të përditësohen automatikisht në kohë reale në raste shtimesh të reja apo ndryshimesh ekzistuese	
013	Ngarkim dokumentacioni nga vete subjektet mbi gjendjen e pagesave	
014	Të dhënat e përditësuara nga sistemet integruese nuk duhet të lejohet të ndryshohen manualisht nga përdoruesit e sistemit.	

Moduli i detyrimeve të subjektit dhe aprovimit.

Nr	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Detyrimet e subjekteve ekzistuese në sistem duhet të shfaqin detyrim specifik për çdo detyrim takse ndaj institucionit të Bashkisë së Tiranës	
002	Hedhje e të dhënave mbi ecurinë e detyrimeve dhe statusin pas pagesave nga vete subjektet përmes vetedeklarimeve	
003	Përshkrim të situatës apo problematikave të hasura që mund të kenë ndikuar në procesin e pagesës, nga vete subjektet	
004	Detyrimet e subjekteve do të paraqiten në mënyrë analitike dhe përmbledhëse	
005	Detyrimet e subjekteve duhet të shikohen dhe kontrollohen nga operatorët (agjentët tatimor) në terren në kohë reale	
006	Detyrimet e subjekteve do të jenë subjekt kontrolli edhe për njësitë e kontrollit të Bashkisë së Tiranës	
007	Detyrimet e subjekteve do të kalojnë në dy nivele kontrolli dhe aprovimi : operatorët dhe njësitë e kontrollit	
008	Detyrimet e subjekteve mund të aprovohen nga operatorët nëse pas kontrollit fizik të subjektit konstatohet se detyrimet në sistem dhe ato reale përkojnë.	
009	Në momentin që operatori është në subjekt, kontrollon online detyrimin në sistem dhe në kohë reale n.q.s deklaratimet që ka bërë subjekti janë të sakta, në aprovimin e tyre duke aksesuar versionin mobile të sistemit përmes tabletave	
010	Verifikim i dokumentacionit të ngarkuar prej subjekteve nga agjentët	
011	Mundësi bashkëngjitje dokumentacioni për agjentët në lidhje me procesin e pagesës dhe detyrimit të subjekteve	

012	Për çdo subjekt do të ruhet informacion nëse është i aprovuar apo i paaprovuar.	
013	Në rast që subjekti është i aprovuar, duhet ruajtur edhe data e aprovimit dhe useri aprovues.	
014	Në rast se subjekti është i pa-aprovuar krahas dates dhe userit aprovues duhet shoqëruar edhe me arsyen/komentin përkatës dhe elementët diferencues	
015	Detyrimet e aprovuara nga operatorët do të ruhen me një datë të caktuar për të bërë edhe verifikimin e detyrimit dhe aprovimit sipas një date përkatëse	
016	Detyrimet e aprovuara nga operatorët nuk mund të editohen dhe modifikohen nga ana e tyre	
017	Kontrolli i planit apo planeve individuale të ofruara nga DPTTV për menyren e procedimit të pageses	
018	Perzgjedhje e planit individual në bazë të të cilit do vazhdojë të kryhet pagesa e detyrimit	
019	Komente mbi mundësinë e ndryshimit të termave të pageses që do u dërgohen DPTTV-se	
020	Leximi i informacionit të akt-marreveshjes për shlyerjen e detyrimeve, mbi bazën e planit individual të zgjedhur	
021	Detyrimet e aprovuara nga operatorët do të jenë subjekt kontrolli për njësitë e kontrollit të Bashkisë së Tiranës	
022	Subjektet dhe operatorët do të jenë subjekt kontrolli për njësitë e kontrollit të Bashkisë së Tiranës	
023	Njësitë e kontrollit duhet të kryejnë aprovimin nga ana e tyre për subjektet e aprovuara ose jo nga operatorët	
024	Rezultatet e verifikimit të njësive të kontrollit do të evidentohen në sistem me aprovimin/mosaprovimin dhe komentën përkatës	
025	I gjithë procesi i deklarimit, aprovimit të deklarimit, kontrollit do të menaxhohet brenda këtij sistemi	
026	Sistemi duhet të ruaj historikun për çdo verifikim dhe aprovim/mosaprovim në nivel operator dhe në nivel kontrollori	

027	Sistemi do të përpunoj të dhënat duke konsideruar veprimet konkrete për secilin rast	
028	Sistemi duhet të siguroj që procesi i kontrollit të deklarimit dhe aprovimit do të jetë në kohë reale dhe i drejtpërdrejtë	
029	Sistemi duhet të siguroj që ndërhyrja në sistem e operatorëve do të jetë minimale duke evituar rrezikun e manipulimit të të dhënave	
030	Sistemi duhet të mundësoj që ndjekja e debitorëve duke pasur të gjithë informacionin e kërkuar të jetë efikase dhe eficiente	

Moduli i monitorimit dhe kontrollit

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Sistemi duhet të siguroj pasqyrim në kohë reale të informacionit mbi detyrimet e subjekteve	
002	Sistemi duhet të siguroj informacion të qartë dhe të saktë mbi listen e debitorëve taksapagues ndaj Bashkisë së Tiranës	
003	Sistemi duhet të mundësoj krijimin e proceseve për ndjekjen e vazhdueshme të subjekteve debitore.	
004	Ne sistemi duhet të jete e mundur hedhja e parregullsive të konstatuara në terren me përshkrim përkatës si: • Mos-regjistrim i biznesit ○ Mos-regjistrim i nipteve sekondare ○ Mos-regjistrim në kategorine e caktuar për disa lloj taksash e tarifash etj • Mos-regjistrim i pronës • Mos-regjistrim i sipërfaqeve të reklames dhe hapësirave publike • Funksionim edhe pas mbylljes, pezullimit në QKB • Regjistrim i sipërfaqeve me të vogla të ndërtësive • Regjistrim në kategori jashtë asaj që është realisht në lidhje me taksën e ndërtësive	

005	Sistemi duhet të munësoj riskedulim dhe krijimin e planeve individuale për taksapagues të ndryshëm duke plotësuar specifikat individuale për raste të ndryshëm.	
006	Kontrollin e komenteve mbi planet individuale të ofruara ndaj subjekteve apo mbi perzgjedhjen e tyre për mënyrën e rene dakord të pagesës	
007	Hedhje e informacionit mbi akt-marreveshjen e lidhur me subjektet për shlyerje të detyrimeve me keste, mbi bazën e planit individual të rene dakord midis paleve	
008	Sistemi duhet të siguroj informacion të qartë dhe të saktë mbi aprovimet/mosaprovimet e operatorëve (agjentëve tatimor	
009	Sistemi do të mundësoj gjenerimin e emailëve apo teksve/sms për njoftimin e subjekteve debitore	
010	Sistemi duhet të gjeneroj historikun e veprimeve për secilin rast.	
011	Sistemi duhet të mundësoj njësitë të kontrollit, informacion të qartë dhe të saktë mbi kontrollet e operatorëve dhe rezultatet e verifikimeve	
012	Sistemi duhet të paraqes informacion të qartë dhe të saktë mbi kontrollet e njësitë të kontrollit dhe rezultatet e verifikimit.	
013	Sistemi duhet të lehtësoj procesin e verifikimit për operatorët dhe kontrollorët	
014	Sistemi duhet të paraqes informacion të saktë mbi shlyerjet e detyrimeve	
015	Sistemi duhet të mundësojë përcaktimin e hapave për arkëtimin e detyrimit	
016	Sistemi duhet të paraqes informacion mbi detyrimet e shlyera dhe të kalkuloj detyrimet e mbetura në kohë reale.	
017	Sistemi duhet të mundësoj gjenerimin e raporteve të saktë dhe të qartë për çdo nivel përdoruesish	
018	Sistemi duhet të gjeneroj raporte përmbledhëse dhe analitike mbi verifikimet e operatorëve sipas karakteristikave të subjekteve dhe intervalit kohor me qëllim planifikimin e kontrolleve	
019	Sistemi duhet ruaj gjurmë për çdo veprim kontrolli të kryer një një datë dhe orë të caktuar	

Moduli i Raportimit

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Sistemi duhet të mundësoj gjenerimin e raporteve të saktë dhe të qartë për çdo nivel përdoruesisht, sipas formateve tabelare, grafike, KPI (performance), etj.	
002	Raportet duhet të gjenerohen në formate të printueshëm dhe të eksportueshëm	
003	Sistemi duhet të ofrojë mundësi të krijuarit të raporteve sipas nevojës, duke mundësuar element raportimi BI (business intelligence) brenda tij.	
004	Te dhënat e raporteve do të ndikohen nga reflektimi i informacionit që bazohet në ngarkimin e të dhënave nga integrimi midis sistemit me sistemet bashkevepruese.	
005	Sistemi duhet të ketë ndërfaqen e vetë të tipit Dashboard, me mundësi personalizimi nga vetë përdoruesit.	
Raportet në vazhdimësi duhet të jenë pjesë e sistemit:		
001	Raport mbi detyrimet e subjekteve për interval kohorë të ndryshme.	
002	Raport mbi subjektet debitore, ditëvonesat, kamatvonesat/gjobat dhe detyrimet totale sipas afateve kohore	
003	Raport mbi njoftimin e taksapaguesve dhe mënyrën e njoftimit	
004	Raport mbi detyrimet e subjekteve për interval kohorë të ndryshme	
005	Raportet përmbledhëse dhe analitike mbi verifikimet e operatorëve në terren, në total dhe në nivel subjekti	
006	Raportet mbi kontrollin e njësive të kontrollit, operatorët dhe subjektet sipas rasteve të caktuara	
007	Raportet mbi operatorët dhe rastet problematike të konstatuara nga njësitë e kontrollit të grupuara në nivel kategorie subjekti dhe takse.	
008	Raport përmbledhës mbi ecurinë mujore të debitorëve përgjatë një periudhe kohore të caktuar	
009	Raport mbi rastet aprovuese/mosaprovuese sipas periudhave kohore me qëllim monitorimi të ecurisë së verifikimeve nga operatorët	

010	Raport mbi numrin e vizitave te agjenteve ne terren	
011	Raport mbi perputhshmerine e parametrave te vetedeklaruar nga subjektet me ato te raportuara nga vizitat fiskale te agjenteve	
012	Raport akumulativ per numrin e bizneseve qe pritet te paguajne detyrimet e prapambetura	
013	Raport krahasues mbi ecurinë e debitorëve duke krahasuar periudha kohore të caktuara	

Aplikacioni Mobile

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Sistemi duhet të ofrohet edhe në formë aplikacioni mobile për t'u aksesuar nga operatorët në terren	
002	Aplikacioni mobile duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i thjeshtë në përdorim	
003	Aplikacioni mobile duhet të paraqese një raportim të thjeshtë dhe në kohë reale për përdoruesit, të detyrimit të subjektit, situatën debitore dhe historikun e veprimeve të ndërmarra deri në atë moment.	
004	Aplikacioni mobile duhet të mundësoje ndjekjen e planeve individuale për subjektet përmes modulit të kalendarit e planifikimeve/skedulimeve	
005	Përdoruesit do të aksesojnë aplikacionin mobile me të njëjtin user dhe password të parakonfiguruar në sistem	
006	Autentikimi i userave dhe të drejtat e aksesimit do të menaxhohen nga administratori i sistemit	
007	Të dhënat e regjistruara nrm aplikacionit mobile duhet të reflektohen në sistem dhe anasjelltas, në kohë reale.	
008	Sinkronizimi sistem-mobile duhet të jetë në kohë reale për përcjelljen e informacionit dhe reflektimin e rezultateve.	
009	Sistemi duhet të mundësoje ngarkimin e fotove apo dokumentave të skanuara në shoqërim të rasteve të verifikimit të subjekteve në terren.	
010	Aplikacioni mobile duhet te ofroje te gjitha funksionalitetet sikurse platforma, duke	

	patur te njejtin nivel sigurie me te, te jete pjese e paketes, jo si element i jashtem.	
--	---	--

Moduli i Administrimit

Nr.	Përshkrim	Përgjigja e ofertuesit
001	Përdoruesit e sistemit caktohen në bazë të drejtash përdorimi, që jepen nga administratori teknik i sistemit. Sistemi do të duhet të mundësojë të drejta fleksibël mbi përdoruesit nga ndërfaqja, ku mund të realizohet shtim/heqje të drejtash. Sistemi duhet të mundësojë të drejta aksesit bazuar në role	
002	Cdo përdoruesi të sistemit duhet t'i përcaktohen të drejtat sipas pozicionit dhe përgjegjësi që ai ka nga administrator teknik i sistemit.	
003	Sistemi duhet t'i ofrojë çdo përdoruesi mundësinë për të vendosur kredencialet e tij personale për aksesimin e sistemit.	
004	Çdo fjalëkalim në sistem duhet të ruhet i enkriptuar.	
005	Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, skadimin e fjalëkalimeve, njoftim për afatin e skadimit etj	
006	Sistemi do të duhet të mundësojë të drejta fleksibël mbi përdoruesit nga ndërfaqja, ku mund të realizohet shtim/heqje të drejtash.	
007	Duhet patjetër të kryhet identifikimi përpara se të hapet profili i përdoruesit.	
008	Përdoruesit e Bashkisë duhet të kenë të drejta në varësi të pozicionit të tyre të punës dhe stukturës organizative të Bashkisë.	
009	Siguria e ofruar duhet të jetë fleksibël në aspektin që mund të menaxhohen të drejtat për të aksesuar menu në sistem, si dhe për të aksesuar ambjente të veçanta brenda moduleve sipas roleve të përdoruesve.	

010	Moduli diferencon tre koncepte: përdoruesit, grupet dhe rolet dhe duhet te suportojë metodën RBAC (Role Based Access Control)	
011	Përdoruesit: persona të identifikueshëm nga një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim, pra persona fizikë.	
012	Një përdorues mund të jetë pjesë e më shumë grupeve dhe të ketë më shumë role.	
013	Shumë karakteristika te sistemit, sidomos të ndërfaqes, duhet të jenë të ndryshueshme për çdo përdorues, në varësi të preferencave.	
014	Grupet: bashkësi për të ravigjësuar të drejtat mbi burimet e sistemit. Të drejtat janë të disa llojeve, minimalisht: të drejta për të shkruar, lexuar apo modifikuar dhe fshirë.	
015	Rolet: përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e përdoruesve. Ato ndërtojnë strukturën hierarkike në trajtë peme. Roli më i lartë ka automatikisht të gjithë të drejtat e roleve më poshtë.	
016	Bashkia duhet të ketë përdorues të vecantë jo vetëm sipas moduleve të sistemit por dhe sipas të drejtave specifike brenda të njëjtit modul	
017	Ky modul duhet të suportojë organizimin e të drejtave sipas parimit të 4- syve: input dhe autorizues (aprovues).	
018	Për cdo përdorues duhet të përcaktohet: emri i përdoruesit, statusi (aktiv/joaktiv), lidhja me punonjësin, të drejtat e aksesit sipas moduleve.	
019	Menutë: Janë të ndara sipas kategorive funksionale. Të drejtat për ti aksesuar duhet të përcaktohen brenda grupeve. Një menu mund të jetë pjesë e disa grupeve.	
020	Grupi të ofrojë rregulla specifike aksesi që përcaktojnë setin e të dhënave që një përdorues i atij grupi mund të aksesojë.	
021	Sistemi është i ndarë në module sipas funksioneve specifike te cilat mund të aktivizohen ose çaktivizohen nga përdoruesi sipas nevojave.	
022	Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e konfigurimit të serverave hyrës dhe dalës për emailt. Të ruajë historik për emailt e nisura nga sistemi dhe statusin e tyre(emaili është dërguar, është marrë, ka dështuar dërgimi)	

023	Të përcaktohen shabllone për emaillet (njoftimet) automatike ku mund të specifikohen dërguesi, marrësi, titulli, përmbajtja.	
-----	--	--

Moduli i gjurmëve (logeve)

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori(përdoruesi), rekordi i ndryshuar	
002	Gjurmët e auditimit duhet të jenë të aksesueshme por të pamodifikueshme nga ndërfaqja e sistemit.	
003	Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, etj	
004	Çdo password në sistem duhet të ruhet i enkriptuar.	

Moduli GIS

Nr.	Përshkrimi	Përgjigjia e ofertuesit
001	Ndihmon në identifikimin e subjektit me anë të paraqitjes në web të informacionit që lidhet me vendodhjen në formën e gjeo informacionit. Përmes tij do të rritet efienca e punës dhe saktësia, duke siguruar informacion të qartë vizual për vendodhjen e subjektit dhe hapësirën e aktivitetit që lidhet me të.	
002	Sistemi do ofrojë një ndërfaqe map viewer dhe funksionalitetet e mëposhtme sipas sugjerimeve të ASIG:	
003	Funksionalitet toolbar të gjuhës (AL dhe EN)	
004	Toolbar të shtresave të hartës (content layer)	
005	Toolbar për zoom - Zmadhim/Zvoglim/Pan/Shtrirje e Plote/Shtrirja - Paraardhese/Shtrirja e Ardhshme/Fshij Zgjedhjen.	
006	Funksionalitet kërkimi në hartë	
007	Identifikim (shfaqje atributesh)	
008	Tabele përmbajtjeje	

009	Mjete editimi online	
010	Informacioni mbi matjet (siperfaqe, gjatesi)	
011	Selection (Query dhe Selection)	
012	Mundesi printimi	
013	Manual perdorimi per perdoruesit e ketij sistemit	
014	Kombinim i të dhënave të aktivitetit të subjektit me të dhëna të tjera gjeohapsinore për të siguruar përfaqësim vizual që përmirëson analizën për vendimarrje dhe pershpejtim të analizave statistikore.	
015	Permes tij do të arrihet me mire edhe perputhshmeria me standardet mjedisore dhe sherbimet utilitare	
016	Moduli do të sigurojë një GIS data viewer në sistem, përfshirë dhe aplikacionin mobile, duke marrë të dhënat nga databaza e sistemit dhe nga databaza e shërbimeve web online, përmes suportit për standarde të ndryshme GIS, dhe do të sigurojë një nivel viewer gjeo informacioni të të dhënave, duke krijuar dhe suportuar një databazë me elemente gjeospaciale.	
017	Të dhënat hapësinore të jenë në sistemin referues gjeodezik KRGJSH-2010. Korniza Rreferuese Gjeodezike Shqiptare që përdoret në Republikën e Shqipërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 07.08.2013 dhe quhet: “Korniza Rreferuese Gjeodezike Shqiptare 2010” ose shkurt (KRGJSH-2010)	
018	Sistemi duhet të suportojë përdorimin e shërbimeve WMS(Web Map Service) ,WFS(Web Feature Service). Sistemi të suportojë komunikimin me Geoportalin shtetëror ASIG, duke përdorur shërbimet WMS ose WFS.	
019	Map Viewer dhe veprime të tjera me hartën, moduli GIS, duhet të ofrohen si funksionalitete në brendësi të vetë platformes	

Komunikimi me sistemin e taksave vendore:

Jane dy momente të rëndësishme për të cilat kerkohet nderhyrja e operatorit ekonomik persa i perket integritimit me sistemet e tjera ekzistente, në vecanti ai i DPTTV.

Se pari, nga ky sistem do furnizohet me të dhënat e nevojshme për funksionim sistemi i ri që do ndërtohet. Baza informative do të merret nga databaza e DPTTV nepermjet leximit të drejtperdrejte të saj apo nepermjet shërbimeve web që duhet të zhvillohen dhe të asistohen nga operatori ekonomik. Gjithashtu, po në këtë fazë, kerkohet edhe dërgimi i të dhënave drejt DPTTV për regjistrimin e shlyerjes së detyrimeve, regjistrime këto që do kryhen nga agjentët e Bashkisë që do përdorin sistemin e ri.

Se dyti, sistemi i DPTTV aksesohet online nga bizneset nepermjet URL dpttv.gov.al nga ku marrin informacion lidhur me detyrimet e tyre. Per te ofruar te njeitin portal edhe per funksionalitetin e vetedeklarimit qe kerkohet te permbushet nga sistemi i ri, eshte i nevojshem zhvillimi i ketij portali nga ana e operatorit ekonomik per te kryer integrimet e nevojshme me sistemin e ri. Njoftimi i bizneseve duhet te kryhet nepermjet njoftimeve me email, perkrah procedures aktuale qe zbatohet.

Komunikimi me sistemet e menaxhimit financiar (ERP):

Sistemet e menaxhimit financiar zakonisht zgjerohen duke shtuar module pasi platforma e ndertuar ka natyre modulare, shume nga funksionalitet dhe te gjitha te dhenat mund te aksesohen nga jashte (Sisteme te tjera) duke perdorur disa menyra:

- Ne nivel baze te dhenash :

Sistemet e menaxhimit financiar perdorin si baze te dhenash PostgreSQL prej te ciles mund te merren lehtesisht te dhena duke perdorur gjuhe te ndryshme programimi si .net, java, php, python etj.

- Nivel web sherbimi :

Sistemet e menaxhimit financiar kane web sherbim te ndertuar e cila aksesohet lehtesisht duke perdorur protokoll XML-RPC ne disa gjuhe te ndryshme programimi si python,java, php, ruby , .net etj.

Sistemi duhet te jetë i pajisur me ndërfaqje komunikimi server-side për të realizuar aksesin e tij nga palë të treta (shërbime të tjera apo aplikacione). Integrimi me aplikacione të tjera kërkon që ky sistem të ekspozohet në formën e shërbimeve web duke mundur në këtë mënyrë që sipas nevojës të kryhen zhvillime nga palë të treta për të përdorur funksionalitetet që ky sistem do ofrojë.

Ndërveprimi duhet të jetë publik, i bazuar mbi protokolle Web HTTP, dhe të mbështesë mesazhe standarde të tipit JSON dhe XML, pa përdorur konvertim eksplisit. Ai duhet të jetë i kontrolluar dhe të ofrojë elemente sigurie konform kërkesave të parashtruara për sigurinë.

Teknologjia e përdorur për të zhvilluar shërbimet Web server-side duhet ndjekë praktikat me te mira, të ofrojë suport të gjerë dhe pa kufizime për pajisje apo teknologjitë e klientëve që do përdorin shërbimet e sistemit, si dhe të ofrojë performancë të lartë dhe shpejtësi përkundrejt kërkesave minimale në burime.

Shërbimet Web duhet të ofrojnë në mënyrë të qartë, të pagabueshme dhe transparente funksionalitetet lidhur me logjikën e biznesit, por pa ekspozuar detaje të kësaj logjike. Sistemi Palët e treta duhen menduar si thin-client (klientet jane transparente dhe te pavarur nga detajet e logjikes se sistemit, gjithcka duhet te kryhet ne server-side), përse i përket logjikës që do ofrojë ky sistem.

Kjo pjesë duhet të konsiderohet si pjesë e arkitekturës së të gjithë sistemit dhe jo si pjesë e ndarë apo modul, duke respektuar parimin DRY (Don't Repeat Yourself) (DRY eshte pjese e praktikave me te mira sipas OWASP persa i perket zhvillimit, cfare duhet te reflektohet dhe te

zgjidhja teknike e ofruar). Në këtë mënyrë, mirëmbajtja dhe përditësimi i funksionaliteteve është më i lehtë dhe afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë çdo konsumator të këtyre shërbimeve. Komunikimi duhet të kryhet duke mos ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë entitetet e databazës, por duhet respektuar parimi i komunikimit vetëm të të dhënave të nevojshme nëpërmjet modeleve respektive, të cilat duhet të implementojnë dhe logjikën e validimit (vleresimit të cilësive të të dhënave) sipas rastit dhe të jenë ngushtësisht të lidhura me tipin e të dhënës.

Pjesë e shërbimit duhet të jetë e pajisur dhe me një seksion të vecantë dedikuar dokumentimit të tij online, i cili duhet të pasqyrojë në mënyrë koherente dhe në çdo moment protokollet në nivel të lartë të thirrjes së metodave, parametrat e tyre, vlerat e kthimit dhe vetitë e modeleve.

13. 2 Raporte

Sistemi duhet të ketë një modul të dedikuar për gjenerimin e të dhënave raportuese mbi aktivitetin dhe informacionin të përpunuar në kohë reale. Raportet duhet të gjenerohen në formate të printueshëm dhe të eksportueshëm. Nder raportet kryesore që do të gjenerojë sistemi duhet të jenë:

- Raport mbi detyrimet e subjekteve për intervale kohore të ndryshme
- Raport mbi subjektet debitore, ditëvonesat, kamatvonesat/gjobat dhe detyrimet totale sipas afateve kohore
- Raport mbi njoftimin e taksapaguesve dhe mënyrën e njoftimit
- Raport mbi detyrimet e subjekteve për interval kohore të ndryshme
- Raporte përmbledhëse dhe analitike mbi verifikimet e operatorëve në terren, në total dhe në nivel subjekti
- Raporte mbi kontrollin e njësisë të kontrollit, operatorët dhe subjektet sipas rasteve të caktuara
- Raporte mbi operatorët dhe rastet problematike të konstatuara nga njësitë e kontrollit të grupuara në nivel kategorie subjekti dhe takse.
- Raport përmbledhës mbi ecurinë mujore të debitorëve përgjatë një periudhe kohore të caktuar
- Raport mbi rastet aprovuese/mosaprovuese sipas periudhave kohore me qëllim monitorimi të ecurisë së verifikimeve nga operatorët
- Raport krahasues mbi ecurinë të debitorëve duke krahasuar periudha kohore të caktuara etj

Të dhënat e raporteve do të ndikohen nga reflektimi i informacionit që bazohet në ngarkimin e të dhënave nga integrimi midis sistemit me sistemet bashkevepruese.

14.KËRKESAT TEKNIKE

14.1 Sistemi software

Sistemi do të mbulojë funksionalitete që duhet të jenë të vlefshme të pakten në 90% të kohës.

Koha e përgjigjes për të gjithë procesimet e sistemit duhet të jetë mesatarisht jo më shumë se 5 sekonda.

Sistemi duhet të jetë i bazuar në Web, për të ofruar mundësi aksesimi kudo ku ka rrjet

Sistemi duhet të :

- Të krijojë dhe ofrojë qasje të menjëhershme në të dhënat, duke përdorur informacionin në bazën e të dhënave dhe një shfletues të thjeshtë Web apo aplikacionin mobile.
- Të promovojë komunikimin dhe bashkëpunimin bazuar në role me të drejta përkatëse, duke ruajtur komponentët e sigurisë
- Të rrisë produktivitetin dhe vendimarrjen
- Të sigurojë një inventar të sakte të objekteve që administrojnë, për të lehtësuar planifikimin dhe përmirësuar komunikimin në një nivel të lartë të departamenteve të brendshme të Bashkisë Tiranë me subjektet.

Sistemi duhet të ruajë të dhënat e regjistruara e të procesuara për një periudhë të caktuar, deri në ruajtjen e tyre në formë arkivore brenda një sistemi tjetër në bashki. Të dhënat duhet të jenë të disponueshme për ripërdorim çdo proces të mëvonshëm, brenda kuadrit ligjor të përdorimit të të dhënave të bizneseve dhe ruajtjes së integritetit të tyre. Të dhënat e depozituara do të ruhen të enkriptuara dhe do të aksesohen vetëm nga sistemi.

Sistemi duhet të ofrojë komunikim të sigurtë mes përdoruesit dhe sistemit, si dhe mes sistemit dhe sistemeve të tjera. Certifikate SSL do të jetë pjesë e dorezimeve.

Zgjidhja dhe Sistemi duhet të garantojnë mekanizma për mbrojtjen e të dhënave dhe aplikacionit, në mënyrë që sistemi të mund të ringrihet brenda një kohe të shkurtër, jo më shumë se 4 ore, në rast dështimi apo kërkesë për rikthim të dhënash. Zgjidhja duhet të suportoje në formë të një parashikimi dhe një plan implementimi për disaster recovery. Testimet e data protection dhe recovery duhet të kryhen periodikisht në bashkëpunim me paleve, në një ambient test.

Sistemi software duhet të integrojë edhe funksionin e dërgimit të njoftimeve me email dhe SMS të subjektet, përfaqësojë fazave të ndryshme të proceseve dhe verifikimeve, ndryshimeve të shërbimeve etj.

Tekstet e njoftimeve duhet të jenë plotësisht të konfigurueshme sipas procesit dhe kërkesës. Moduli duhet të integrohet me shërbimet e mail server dhe me SMS gateway të bashkisë Tiranë.

Sistemi mobile duhet të përmbajë këto elemente sigurie:

- Thin client, që do të sigurojë operimin si një sistem operativ. Të gjitha të dhënat dhe proceset e aplikacionit duhet të jenë në një server qendror, duke mos mbajtur asgjë në mobile.
- Autentikimi dhe autorizimi duhet të kryen me Token në çdo thirrje
- Token based authentication, duhet të dërgohet në çdo kërkesë, duhet të mbrohet me protokollin e komunikimit HTTPS ssl

- Funksionimi duhet te jeten mbi bazen e Web API qe fsheh detajet e tjera ne Business Logic dhe ekspozon vetem metodat e nevojshme si dhe te dhenat ne nje format te mirepercaktuar, per te cilat duhet te behet validim.

14.2 Certifikata SSL

Certifikata SSL duhet te jete e vlefshme per 4 vite, e vlefshme per multidomain names (te pakten 4 emra SAN), Suport per emrat dhe brandet me te njohur te sistemeve operative, browserave desktop dhe mobile, platformat e serverave, pajisjet mobile

14.3 Infrastruktura hostuese

Bashkia Tiranë disponon infrastrukture hostuese te tipit EMC VxRail cluster me gjashte nyje eksistuese si dhe mundesi zgjerimi deri ne 64 nyje procesimi.

Per kete sistem eshte menduar te dedikohet nje nyje procesimi i re pasi nyjet ekzistuese jane ne perdorim si me poshte :

- | | |
|------------------------------------|--------|
| • Exchange Server 2010 | 2 Nyje |
| • Sistemi Financiar | 2 Nyje |
| • Sistemi i Menaxhimit te hoteleve | 2 Nyje |

Sistemi i aktual i taksave hostohet ne nje infrastrukture te ndryshme nga kjo e paraqitur me siper.

Pajisje Nyje Procesimi per njesine ekzistuese Hyperconverged VXRail 60 V4.2Q-CHASSIS-1200PS e perputhshme dhe e pershtatshme per shtimin e e nyjes se procesimit e re qe perdor Vmware vSphere 6 Enterprise si platforme virtualizimi, si pjese e paketes software te perdorur.

Pajisja duhet te jete e pajisur minimalisht me:

- Processor E5-2603 v3 1.6 GHz ekuivalent me min. 5100 pike sipas cpubenchmark.net
- 1 x 200GB SSD,
- 5 x 1.2TB SAS 10K 2.5 inch,
- 64 GB RAM
- Garanci hardware min per 1 vit,
- licensim Vmware vSphere 6 Enterprise Plus per 1 processor dhe Basic support per 4 vjet,
- integrim ne cluster me 6 nyjet ekzistuese

14.4 Upgrade i sistemit te sigurise

Bashkia Tirane ka ne perdorim pajisje Fortinet FG-100C, e cila eshte “end of line” qe do te thote nuk mund te blihen licensa per kete produkt si dhe te ofrohet suport.

Nisur nga fakti qe politikat e sigurise se rrjetit jane ngritur dhe funksionojne mbi ketë teknologji, zevendesimi i saj me nje tjetër ekuivalente sipas politikave te zevendesimit nga prodhuesi eshte zgjidhja optimale qe jep mundesi për koston me te ulet te blerjes se pajisjes dhe koston me te ulet operacionale. Per keto arsye nga operatori ekonomik kerkohet furnizim dhe instalim i pajisjeve firewall, ekuivalent dhe i pershtatshem me sistemin aktual ne funksion te riperdorimit te politikave dhe konfigurimeve ekzistuese ne gjithë rrjetin me specifikimet e meposhtme:

Specifikime minimale teknike paraqiten me poshte:

Enterprise, NGFW, Antivirus, Web Filtering, Antispam, Botnet IP/Domain protection, dhe Mobile Security

Porta SFP	2 Porta SFP
Porta RJ-45	12 GE
Porte Console	1 porte
Porta HA	2 Porta HA

14.5 Tokens per autentikim me dy faktore

Furnizim dhe konfigurim i 70 x Tokens qe do te perdoren per autentikim te sigurte te agjenteve me pajisjet e tyre fundore, te pershtatshme per menaxhim dhe regjistrim te perqendruar nga pajisjet e sistemit e sigurise ne piken 14.4, ose ekuivalente me to Operatori ekonomik mund te ofroje bashke me Tokens edhe nje sistem autentikimi redundant te jashtem qe do te sherbeje per autentikimin me dy faktore te tokens dhe qe duhet te integrohet me gjithë sistemin.

2FA tokens te jene me keto karakteristika:

- OTP gjenerator OATH time and event-based
- Kopjim i OTP ne clipboard
- Display i OTP time interval dhe serial number
- Menaxhim i tokens dhe aplikacionit
- Mbrojtje nga fshirjet me force
- Platformat e suportuara: iOS (iPhone, iPod Touch, iPad), Android, Windows Phone 8, 8.1, and Windows 10 Mobile,

Funksioni i tyre eshte autentikimi i sigurte i agjenteve ne terren, meqenese jane subjekt i demtimeve apo nderhyrjeve fizike te padeshiruara.

14.6 Tablet PC

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e Procesorit:	1.6 GHZ
Processor Cores:	Quad Core
"RAM":	2 GB DDR3
Internal Memory:	32 GB

Removable Memory:	Të suportoje Micro SD deri në 32 GB
Sensors:	G-Sensor Internal GPS- Internal
“Display”:	9.7” LED 1024x768 multitouchscreen IPS Technology
“Battery”:	Minimumi 6300 mAh ose minimum 8 orë punë
“Camera”:	Front Facing 2 Megapixel Main Camera 3 Megapixel
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e komunikimit “Ports”:	Micro USB Headphone jacks 3.5 mm
“Networking”:	GSM 3G Internet Wireless 802.11 b/g/n/ac Bluetooth
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	Po
AKSESORËT	
Ushqyesi “Recharger”:	Po, European 220v/50Hz
Çantë dhe Flip Cover:	Po
Periudha e mbulimit të garancisë “Warranty”:	1 vit

I vetmi specifikim që kërkohet më shumë nga standardi i AKSHIt është kapaciteti i baterisë, i cili kërkohet më shumë se 4 orë, pra 8 orë për arsye sepse agjentët mund të jenë në terren gjatë gjithë ditës së punës dhe duhet të kenë akses në sistem në cdo kohë që do të jetë e nevojshme për ta, pa qenë të varur nga burimi i ushqimit të pajisjes.

14.7 Njesi qendrore per ruajtjen dhe ngarkimin e tabletave

Funksioni i saj eshte ruajtja ne menyre te perqendruar e Tablet PC ne ambjentet e Bashkise pas perfundimit te orarit te punes, nje njesi qendrore per karikimin e njekohshem dhe te kontrolluar te Tablet PC, i pajisur me priza ushqimi.

E pershtatshme per jo me pak se 38 tableta, notebook, deri ne 45mm trashesi, dhe 15 inch madhesi

Me dalje dhe hyrje te pershtatshme per furnizimin me energji dhe ngarkimin e pajisjeve

Duke perdorur adaptoret e ushqimit te cdo pajisje

Me ventilim per ftohjen e njesise

Me dalje ushqimi AC per furnizimin e pajisjeve ndihmese (printer, skaner etj)

Me mundesi per lidhjen ne rrjet

Hyrjet/daljet e energjise: 220VAC, 50/ Hz

Garancia: jo me pak se 3 vjet

14.8 Instalimi dhe integrimi i elementeve te infrastruktures

Operatori ekonomik duhet te instaloje dhe integroje ne infrastrukturen e bashkise te gjithë elementet e perfshire, sipas nje plani te miratuar nga palet, me theks te vecante ne sigurine e rrjetit dhe sherbimeve, kohen downtime, dhe risqet.

